



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



|          |               |               |
|----------|---------------|---------------|
| 1        | Data 28.11.23 | Vendi KAÇANIK |
| Nj. org. | Numri         | Shtojcë       |
| 01       | 370/01-30207  | X             |



Kuvendi i Komunës  
Skupština Opština  
Municipal Assambly

## KONTRATA PËR PUNË

**Komuna e Kaçanikut** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Shefket Koxha – Menaxher i prokurimit**; në njérën anë dhe

**"PLUS TRADE" L.L.C nga Ferizaji** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar ngai **Përpaim Dalloshi** ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

### Mirmbajtja dhe rregullimi i ndriqimit në rrjetet eksistues të ndriqimit publik

me numër Identifikues : **652-23-11152-5-3-6**

**KA652/23/095/536**

**Neni 1**            **Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të **Mirmbajtja dhe rregullimi i ndriqimit në rrjetet eksistues të ndriqimit publik**

1.2 Kontrata hynë në fuqi **27.11.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **25 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **Komuna Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

**Neni 2**            **Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

**Neni 3**            **Çmimi**

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **6,383.00 €;**  
**me fjalë (Gjashtëmijëtreqindëtetëdhjetëetëtreuro )**

<sup>1</sup> DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimet të çmimit sipas bersës përkatëse).

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

#### Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të punëve nga na e menagjérit të projektit si dhe komisionit për pranim të punëve

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të **punëve**.

#### Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [fumizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përaparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për tu dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e

caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) la jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

#### Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti Kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimit nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

#### Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.



#### Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] [Srbisht] [Anglisht] 2 në tri origjinalë, dy origjinalë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

|             |   |             |   |
|-------------|---|-------------|---|
| Emri:       | Përparim Daloshi  | Emri:       | Shefket Koxha   |
| Pozita:     | Drejtør   | Pozita:     | Menagjer i Prokurimit   |
| Nënshkrimi: |  | Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 27.11.2023  | Data:       | 27. XI. 2023  |
| Vula:       |  | Vula:       |   |

**Paramasa për mirëmbajtje dhe rregullimin e rrjetit të ndriçimit publik ekzistues në komunën e Kaçanikut**

| Nr.I           | pershkrimi i pozicionit   | Njësia | Sasia  | Çmimi për njësi | Totali            |
|----------------|---|--------|--------|-----------------|-------------------|
| 1              | Furnizimi dhe montimi Kabllos 3x2.5 mm <sup>2</sup> ,Cu   | m'     | 120.00 | 0.75            | 90.00 €           |
| 2              | Furnizimi dhe montimi Siguresa Automatike 32 A  | copë   | 10.00  | 2.10            | 21.00 €           |
| 3              | Furnizimi dhe montimi Siguresa Automatike 16 A  | copë   | 10.00  | 2.10            | 21.00 €           |
| 4              | Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave LED për ndriçim publik të tipit DORADA DR 72-60W ose të ngashme . Llampat të janë sipas detalit të dhënë - Luminous flux: 13400 lm,<br>- Color Temperature: neutral white 3000K - URCE: LED diodes of constant, eye-friendly neutral white color temperature (4200K), superior performance and rated lifetime L70 of 50 000 hours. Para vendosjes ato duhet të miratohen nga organi mbikëqyrës.  | copë   | 253.00 | 17.00           | 4,301.00 €        |
| 5              | Furnizimi, transporti dhe montimi i llampave LED për ndriçim publik të tipit DORADA DR 72-100W ose të ngashme . Llampat të janë sipas detalit të dhënë - Luminous flux: 13400 lm,<br>- Color Temperature: neutral white 6000K - URCE: LED diodes of constant, eye-friendly neutral white color temperature (4200K), superior performance and rated lifetime L70 of 50 000 hours. Para vendosjes ato duhet të miratohen nga organi mbikëqyrës. | copë   | 50.00  | 30.00           | 1,500.00 €        |
| 6              | Furnizimi dhe montimi I nderpresit automatik- fotoçeli 220v,50Hz per ndriçim  | copë   | 10.00  | 20.00           | 200.00 €          |
| 7              | Kontaktor -40,500V,40 A   | copë   | 10.00  | 25.00           | 250.00 €          |
| <b>Totali:</b> |   |        |        |                 | <b>6,383.00 €</b> |

P.S. Para fillimit te punimeve tokësore , punëkryesi është I obliguar që ti njoftojë me shkrim: KEDS-in,PTK, Ndërmarrjen Publike "Bifurkacioni për fillimin e punimeve me qellim të evitimit të dëmtimit të infrastrukturës përkatëse ,dhe për çdo dëmtim të infrastrukturës pasojat financiare i bartë ekzekutives i punimeve dhe është i obliguar që ti sanoj defektet e mundshme. Në çmim të përfshihet furnizimi montimi dhe përdorimi i autokorpës për montimin e këtyre elemeneteve(realizimin e pozicioneve)

Kaçanik, 2023

E PNUAR NGA: Arian Teneqja